




e
Rahovecit

RAHOVECI RANGOHET NË KRYE TË INDEKSIT TË TRANSPARENCËS
BUXHETORE NGA INSTITUTI GAP

Komuna e Rahovecit është renditur në mesin e komunave më transparente në Kosovë, duke arritur rezultatin maksimal prej 100 pikësh në Indeksin e Transparencës Buxhetore, të publikuar nga Instituti GAP. Ky vlerësim dëshmon angazhimin e vazhdueshëm të Komunës së Rahovecit për menaxhim të përgjegjshëm të financave publike, transparencë në proceset buxhetore dhe informim të rregullt të qytetarëve. Rezultati maksimal reflekton përkushtimin në publikimin me kohë të dokumenteve buxhetore, rritjen e llogaridhënies dhe



Në Krushë të Madhe filloi festivali "ChilliFestë"

Edhe këtë vit nisi edicioni i festivalit të perimekulturës «ChilliFestë».

Ky festival, që i dedikohet perimekulturës, është bërë shumë i rëndësishëm për të gjithë bujqit në Krushë të Madhe, Rahovec, por edhe më gjerë, i cili mbahet në kuadër të muajit të mërgimtarëve. "ChilliFestë" është bërë një prej mënyrave më të mira për ta promovuar kultivimin e perimeve.




Komuna e Rahovecit dhe Komuna e Vakaricit nënshkruajnë Deklaratën e Miqësisë

Komuna e Rahovecit, vizitoi Komunën e Vakaricit, me ç'rast krerët e të dyja komunave, nënshkruan Deklaratën e Miqësisë.

Gjithashtu, Kryetari i Komunës së Rahovecit, z. Smajl Latifi, i shoqëruar nga kabineti i tij, mori pjesë në Festivalin e Kostumeve të Kulturës Arbëreshe, një manifestim që e pasqyron historinë, kulturën dhe identitetin e arbëreshëve, të ruajtur ndër breza.

Përmes kësaj deklarate synojnë të ndërtojnë bashkëpunime konkrete në kulturë, në arsim, në rini, në turizëm dhe në ekonomi, duke krijuar mundësi të reja për shkëmbim dhe bashkëpunim ndërmjet dy vendeve.



2.11 milionë euro për Projektin e Banimit Social Adekuat në Komunën e Rahovecit

Komuna e Rahovecit ka përfituar një grant në vlerë prej 2.11 milionë eurosh për financimin e Projektit për Banimin Social Adekuat.

Marrëveshja e grantit u nënshkrua sot nga kryetari i Komunës së Rahovecit, z. Smajl Latifi dhe ministria në detyrë e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, znj. Fitore Pacolli. Në kuadër të këtij projekti, fondet do të përdoren për: 1.5 milionë euro për ndërtimin e njësisë të reja të banimit social; 225 mijë euro për rinovimin e shtëpive; 385 mijë euro për rindërtimin e shtëpive.

Ky investim synon të përmirësojë kushtet e banimit për familjet në nevojë dhe t'u sigurojë atyre kushte më të përshtatshme dhe më dinjitoze të jetesës.

